



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2025:234529
Datë: 27.03.2026
Numri i dokumentit: 08681997

K.DH.SH. II.nr.405/26

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fisnik NULI, kryetar i Kolegjit, Alajdin TËRSHNJAKU dhe Dren ROGOVA anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit-propozuesve të masës së sigurimit Korporata Energjetike e Kosovës - KEK me seli në Prishtinë, kundër të paditurave/kundërshtarëve të masës së sigurimit 1. Prishtina Parking me seli në Prishtinë, dhe 2. Komuna e Prishtinës, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të masës së sigurimit e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomave të shkallës së parë-Departamenti i Përgjithshëm KP.nr.3/26 datës 19.02.2026, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 26.03.2026, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit-propozuesit të sigurimit Korporata Energjetike e Kosovës - KEK me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimit i Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti i Përgjithshëm, nr. KP.nr.3/26 të datës 19.02.2026, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Komerciale–Dhomat e shkallës së parë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin ankimor KP.nr.3/26 datës 19.02.2026, e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e paditësit-propozuesit të sigurimit Korporata Energjetike e Kosovës - KEK me seli në Prishtinë, e i cili ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit dhe të të ndërpritet veprimtaria afariste e kundërshtarëve të masës së sigurimit, në paluajtshmëritë me numër 6219-1, 6219-2, 6218-0, 6225-0, 6223-0,

6222-0 dhe 3221-0, Z.K. Prishtinë, të cilat gjenden në rrugët “Simon Shiroka, “Nurije Zeka” dhe “Miss Edi Durham”.

Kundër këtij aktvendimi ka paraqitur ankesë propozuesi i masës së sigurimit, me te cilën, e kundërshton aktvendimin e atakuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet në tersi si e bazuar ankesa e propozuesit të masës së sigurimit, të ndryshohet aktvendimi KP. Nr.3/26 dt. 24.12.2025, në atë mënyrë që të caktohet masa e sigurisë, duke urdhëruar të ndërpritet veprimtaria afariste e kundërshtarëve të masës së sigurimit, në paluajtshmëritë me numër 6219-1, 6219-2, 6218-0, 6225-0, 6223-0, 6222-0 dhe 3221-0, Z.K. Prishtinë, deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit. Ose alternativë të Prish Aktvendimin e ankimuar dhe ta kthej çështjen në rishqyrtim-rivendosje në shkallë të parë.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, lidhur me aktvendimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

-Ankesat është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i masës së sigurimit ka kërkuar që të i ndalohe kundërshtarit të propozimit të masës së sigurisë veprimtaria afariste në paluajtshmëritë me numër 6219-1, 6219-2, 6218-0, 6225-0, 6223-0, 6222-0 dhe 3221-0, Z.K. Prishtinë, të cilat gjenden në rrugët “Simon Shiroka, “Nurije Zeka” dhe “Miss Edi Durham”. Tutje Nga shqyrtimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton se propozuesi në këtë fazë të procedurës nuk ka ofruar prova bindëse me të cilat do të vërtetonte pretendimet e tij, lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit, andaj edhe rrjedhimisht rezulton që propozuesi i masës së sigurimit, në këtë stad të procedurës nuk i ka plotësuar kushtet e përcaktuar sipas pikës a) dhe b), të nenit 297 të LPK-së.

Gjykata Komerciale–Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin ankimor ka Refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurimit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, Dhomat e shkallës së parë, i është referuar dispozitave ligjore te nenit 297.1 nën pikën a) dhe b)

të LPK-së, me të cilin përcaktohet se: *“Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*. Ndërsa me nenin 300 te LPK-së është përcaktuar se *“për sigurimin e kërkesës i drejtuar ka sendi i caktuar apo për kah një pjesë e tij mund te caktohen disa lloje te masave te sigurimit”*, ndërsa me nenin 304 par.3 te LPK-së është përcaktuar se *“propozuesi i tij duhet t'i tregoj edhe faktet mbi të cilat mbështet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjete provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara me propozim, si dhe këto mjete provuese t'ia bashkëngjis propozimit”*. Bazuar në dispozitat e sipërcituara, për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen në mënyrë komulative kushtet ligjore sipas të cilave propozuesi duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës, si dhe ta bëjë të besueshëm faktin se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së saj.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit, për faktin që propozuesi i masës së sigurimit, nuk e ka bërë të besueshëm plotësimin e kushteve të përcaktuar në nenin 297.1 pika a) dhe b) të LPK-së, përkatësisht propozuesi në këtë fazë të procedurës nuk ka ofruar prova bindëse me të cilat do të vërtetonte pretendimet e tij, lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Tutje gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nuk plotësohet as kushti i dytë ligjor për caktimin e masës së sigurimit, respektivisht ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, pasi që në rastin konkret kërkesa është paraqitur ndaj Komunës së Prishtinës dhe Ndërmarrjes Publike Lokale Prishtina Parking, të cilat nuk mund të shuhen e as ti nënshtrohen ndonjë procedure të falimentimit, nga e cila do të rrezikohej realizimi i kërkesës së propozuesit, andaj nuk ekziston asnjë rrezik që paditësi në të ardhmen të mos mund ta realizojë kërkesën e tij, në rast se kërkesëpadia e tij rezulton si e bazuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve Kolegji gjene se, Dhoma e Shkalles se Parë-Departamenti i Përgjithshëm në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit si të pabazuar propozimin e propozuesit te masës së sigurimit dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e refuzimit të propozimit. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që nga shqyrtimi i çështjes nuk janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet e përcaktuara me dispozitat e nenit 297 të LPK-së, ngase qartë rezulton që në rastin konkret nuk plotësohet kushti i dytë ligjor për caktimin e masës së sigurimit respektivisht lidhur me ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës eventuale në të ardhmen, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të masës së sigurimit, kjo për faktin që kërkesa e paditësit/propozuesit është paraqitur ndaj Komunës së Prishtinës dhe Ndërmarrjes Publike Lokale Prishtina Parking, të cilat nuk mund të shuhet e as ti nënshtrohen ndonjë procedure të falimentimit, nga e cila do të rrezikohej realizimi i kërkesës së propozuesit, andaj nuk ekziston asnjë rrezik që paditësi në të ardhmen të mos mund ta realizojë kërkesën e tij, në rast se kërkesëpadia e tij rezulton si e bazuar.

Në raport me këto pretendime ankimore Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton se në arsyetimin e aktvendimit të atakuar, në mënyrë të qartë janë dhënë arsye te mjaftueshme se nuk plotësohen kushtet ligjore që kërkohen me nenin 297 te LPK-së.

Sipas vlerësimit të Dhomës së Shkallës së Dytë, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Dhoma e Shkallës së Dytë nuk i konsideroi si të bazuara pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur shkelje në dëm të palës propozuesi duke mos aprovuar te njëjtën. Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë e ka pranuar vlerësimin dhe përfundimin e shkallës së parë, pasi që gjykata e shkallës së parë, i ka vlerësuar pretendimet e palëve propozuesve të sigurimit dhe duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të ankuesit në ankesë, Kolegji vlerëson se te njëjtat tërësisht janë e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të pretendimeve te palëve ndërgjyqëse, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin ndryshe në këtë çështje juridike.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 194, 208 dhe nenit 209 pika (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.405/26 datë 26.03.2026

Kryetar i Kolegjit,
Fisnik NULI